

## Titulli i lëndës: Sintaksë e shqipes I (Sintaksë e fjalisë)

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe
Titulli i lëndës:	Sintaksë e shqipes I (Sintaksë e fjalisë)
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III, semestri V
Numri i orëve në javë:	2 + 4
Kreditë ECTS:	7
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Kadire Binaj - Ejupi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:kadire.binaj@uni-pr.edu">kadire.binaj@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Sintaksë e fjalisë trajton njësitë sintaksore përbërëse të fjalisë, pra sintagmat, duke i parë llojet e tyre, rregullat e klasifikimit të tyre dhe kombinimet e mundshme të tyre për krijimin e fjalive. Sintagmat e caktuara, varësisht nga relacionet që krijojnë në fjali, kryejnë funksione të caktuara sintaksore. Analiza funksionale e fjalisë është pjesë e rëndësishme e këtij kursi. Gjithashtu, në kuadër të këtij kursi do të trajtohen edhe llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies, sipas modalitetit dhe sipas strukturës.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që studentët të njihen me konceptet themelore të sintagmave në përgjithësi dhe rregullat e klasifikimit të tyre në sintagma emërore, mbiemërore, foljore, parafjalore e ndajfoljore. Gjithashtu, përmes këtij kursi synohet që studentët t'i identifikojnë edhe funksionet sintaksore që i luajnë sintagmat e caktuara, varësisht nga folja me të cilën kombinohen për të formuar një model të caktuar të fjalisë në gjuhën shqipe.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- t'i identifikojë dhe t'i veçojë të gjitha strukturat sintagmatike të shqipes bashkë me funksionet e ndryshme të tyre;
- të bëjë analizë sintaksore të kategorive funksionale dhe strukturore brenda fjalisë së thjeshtë apo brenda një hierarkie më të lartë gjuhësore;
- t'i dallojë modelet bazike të fjalive në gjuhën shqipe (modelet e kombinimit të përbërësve në fjali) dhe t'i analizojë elementet që e determinojnë strukturën e një fjalie;
- t'i identifikojë strukturat dhe funksionet e ndryshme sintaksore brenda fjalisë së thjeshtë në situata të ndryshme të komunikimit
- t'i dallojë konceptet themelore të analizës sintaksore në përgjithësi dhe të analizës së sintagmës në veçanti.

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	4	15	60
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	4	2	8
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	10 min	15	2.5
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	15	45
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>184: 25= 7.35 7 ECTS</b>

<p>Metodat e mësimdhënies:</p>	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve praktike. Gjatë orëve të ligjëratave studentëve do t'u ofrohet baza teorike relevante për këtë kurs, ndërsa gjatë orëve të ushtrimeve ata do ta zbatojnë dijen teorike për të bërë analiza të caktuara të sistemit sintaksor të shqipes.</p> <p>Ligjëratat do të organizohen në mënyrë interaktive: duke diskutuar për tema e probleme të caktuara me studentët pas leximit të pjesës teorike nga ta. Gjatë ushtrimeve mësimdhënësia do të jetë e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi do ta orientojë rrjedhën e orës dhe do t'i diskutojë e sqarojë konceptet e problemet që janë të paqarta për studentët. Gjatë orëve të ushtrimeve studentët, gjithashtu, do t'i prezantojnë detyrat e shtëpisë të cilat do t'i diskutojnë me mësimdhënësin e kolegët.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10%</li> <li>- Detyrat e shtëpisë 10%</li> <li>- Testi i parë 40%</li> <li>- Testi i dytë 40%</li> <li>- Gjithsej 100%</li> </ul>
<p>Literatura primare:</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002</li> <li>- Thoma Dhima, Gjuha shqipe – Sintaksa, Tiranë, 2005</li> <li>- Turano, Koleci, Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes, SHBLU, Tiranë, 2011</li> <li>- G. Graffi, Sintaksa (Strukturat e ligjëritimit), Dituria, Tiranë, 2003</li> <li>- Kadire Binaj - Ejupi, Modelet strukturore të fjalive në gjuhën shqipe, ZeroPrint, Prishtinë, 2021</li> </ul>
<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe II</li> <li>- Remzi Përnaska, Kundrinori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe, Shtëpia botuese Dukagjini, Prishtinë, 1996</li> <li>- Mehmet Çeliku, Sintaksë e gjuhës shqipe, Tiranë 2012</li> <li>- Lindita Sejdiu- Rugova, Strukturë dhe funksion: studime në sintaksë të shqipes, Trembelat, Prishtinë, 2019</li> <li>- Quirk et al., A Comprehensive Grammar of the English Language. Longman, London, 1985</li> <li>- Lyons J. (2001). Hyrje në gjuhësinë teorike. Tiranë: Dituria</li> <li>- Huddleston R., Pullum G. K., The Cambridge Grammar of the English Language. Cambridge: CUP, 2002</li> <li>- Herbst et al. (2004). A Valency Dictionary of English. Mouton de Gruyter (formerly Mouton, The Hague), Division of Walter de Gruyter GmbH &amp; Co. KG, Berlin.</li> <li>- Floqi S. (1978). Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme letrare. Në: SF 4. Tiranë: ASHRPSH (25-51)</li> </ul>

- Dykro Osvald, Todorov Cvetan (1984). Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjëritimit, Prishtinë, Rilindja
- Buchholz O., Fiedler W. (1987). Albanische Grammatik, Leipzig: Verlag Enzyklopädie
- Buxheli L. (2007), Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë: Neraida
- Buxheli L. (2011). Foljet njëvetore në gjuhën e sotme shqipe. Tiranë: QSA

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i silabusit. Njësitë gramatikore dhe konceptet gramatikore të sintaksës.
Java 2:	Tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit; Fjalitë pohuese dhe mohuese
Java 3:	Sintagma – kriteret e klasifikimit
Java 4:	Sintagma emërore dhe foljore
Java 5:	Sintagma mbiemërore, ndajfoljore dhe parafjalore
Java 6:	Funksionet e sintagmave: kryefjala dhe kallëzuesi
Java 7:	Funksionet e sintagmave: kundrinorët
Java 8:	Testi i parë
Java 9:	Funksionet e sintagmave: plotësit kallëzuesorë
Java 10:	Funksionet e sintagmave: rrethanorët
Java 11:	Modelet e fjalive të thjeshta: folja, komplementët dhe adjunktët
Java 12:	Modelet e fjalive me folje zero- dhe një-valente
Java 13:	Modelet e fjalive me folje dyvalente
Java 14:	Modelet e fjalive me folje trivalente
Java 15:	Testi i dytë

## **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.